



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 49 .datë 04 . 08 2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR KRYETARIN E BASHKISË Z. ADRIATIK MEMA PËR TË FIRMOSUR KONTRATËN, PËR GRANTIN E FITUAR ME Nr. 152 PROT, DATË 25.07.2022, DHE ME Nr. REFERENCE TË APLIKIMIT: EU4M-CIP-2-A2, NDËRMJET BASHKISË DHE SHOQATËS “NETËORK OF ASSOCIATIONS OF LOCAL AUTHORITIES OF SOUTH-EAST EUROPE” - NALAS ME THIRRJEN E DYTË TË SKEMËS SË GRANTEVE “BE PËR BASHKITË”

Këshilli i Bashkisë Skrapar , në mbledhjen e datës 04.08.2022, pasi mori në shqyrtimi projekt aktin e hartuar nga Bashkia Skrapar, në mbështetje të ligjin nr.139/2015, datë 17.012.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, vendimin e Këshillit të Bashkisë, nr. 65, datë 24.12.2021, “Për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”, letrën e njoftimit nr. 152, datë 23.07.2022, për projektin “Ndërtimi i Ambienteve Sportive në shkollën Zylyftar Veleshnja”, Bashkia Skrapar,

VENDOSI

1. Dhënie autorizimi për kryetarin e Bashkisë, Z. Adriatik MEMA, për të firmosur kontratën e grantit të fituar, me Nr. 152 Prot., datë 25.07.2022, me nr. reference aplikimi EU4M-CIP-2-A2, ndërmjet Bashkisë Skrapar dhe Shoqatës “Netëork of Associations of Local Authorities of South-East Europe” - NALAS , në thirrjen e dytë të skemës së granteve “BE për Bashkitë”, në kuadër të projekt propozimit “Ndërtimi i Ambienteve Sportive në shkollën Zylyftar Veleshnja”.
2. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, midis Bashkisë Skrapar dhe Shoqatës “Netëork of Associations of Local Authorities of South-East Europe” - NALAS, në thirrjen e dytë të skemës së granteve “BE për Bashkitë”, në kuadër të projektit “Ndërtimi i Ambienteve Sportive në shkollën Zylyftar Veleshnja”. Buxheti total i projektit është 55.555Euro.
3. Miratimin e bashkëfinancimit e Bashkisë Skrapar, të projektit “Ndërtimi i Ambienteve Sportive në shkollën Zylyftar Veleshnja”, sipas buxhetit të miratuar në Projekt Propozim, si dhe miratimin për mbulimin e TVSH-së së projektit të miratuar, parashikuar në buxhetin e vitit 2022 dhe buxhetit afatmesëm.
4. Angazhimin e institucionit Bashkia Skrapar për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes për projektin “Ndërtimi i Ambienteve Sportive në shkollën Zylyftar Veleshnja”, pas përfundimit të garancisë së punimeve nga projekti, parashikuar kjo në materialet e planifikuara për blerjet e vitit 2022-2023.
5. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohen: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve, si dhe Sektorit i Integritimit European dhe Projekteve.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
7. Vendimi u miratua me 11 vota pro, vota kundër s'ka, vota abstenim s'ka

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

EDLIRA SHKMBI

